



Funded by
the European Union

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

EDITORIAL

“Ndikimi i Pandemisë Covid-19 në Arsimin Parauniversitar në Kosovë: Sfida dhe Mundësi”

Situata e krijuar për shkak të pandemisë Covid-19 ka imponuar ndryshime të mëdha në procesin edukativo-arsimor në Kosovë, posaçërisht në arsimin parauniversitar. Në këtë pikë, nevoja për një analizë të thellë të gjendjes aktuale dhe zhvillimeve përkatëse është thelbësore, me qëllim të identifikimit të mënyrave më efikase për një proces mësimor adekuat dhe cilësor. Për të kuptuar impaktin e pandemisë në arsimin parauniversitar, projekti një-vjeçar **Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021**, i financuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe i jetësuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), përpiloi një raport të titulluar “*Ndikimi i Pandemisë Covid-19 në Arsimin Parauniversitar në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë*” (prej këtu e tutje ‘Raporti’). Ky raport identifikon sfidat me të cilat po përballlet arsimi parauniversitar në Kosovë, përshkruan kuadrin e masave dhe politikave të zhvilluara gjatë kësaj periudhe, si dhe parashtron mundësitë për reagim sa më efektiv ndaj rrethanave të reja të krijuara.

Me qëllim të prezantimit të gjetjeve të Raportit, më 26 tetor 2021 KEC-i organizoi një diskutim virtual në platformën elektronike Zoom. Në ngjarje ishin të pranishëm 51 pjesëmarrës/e të cilët përfshinin përfaqësues nga Zyra e BE-së në Kosovë, zyrtarë/e nga MASHTI dhe DKA-të e komunave të ndryshme të Kosovës, drejtorë/e shkollash, mësime/mësues/e, autorin e Raportit si dhe persona që kanë kontribuar në hartimin e Raportit përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve.

Prezantimi i Raportit u fokusua në tre aspekte kryesore: sfidat, mundësitë dhe rekomandimet.

Disa prej **sfidave** kryesore të identifikuara ishin menaxhimi i personelit arsimor gjatë pandemisë, ngarkesa e shtuar për mësime/mësues/e, trajtimi i humbjeve mësimore, thellimi i pabarazive në arsim - posaçërisht tek grupet e margjinalizuara, mungesa e një mekanizmi institucional qendror për digjitalizimin e arsimit, mungesa e një sistemi mbështetës për prindër/kujdestarë me udhëzime se si t’i qasen mësimit në shtëpi me fëmijët e tyre, shërbime të pamjaftueshme psikologjike në shkolla për trajtimin e situatës, mungesa e një kornize monitorimi dhe raportimi për procesin mësimor në kushtet e pandemisë me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe llogaridhënies etj.

Nga ana tjetër, Raporti identifikoi **mundësitë** e shfaqura, të cilat duhen shfrytëzuar për reagim më efektiv ndaj mësimit në kushtet e pandemisë, ku thelbësor është të kuptuarit se teknologjia është instrument tejet efikas për mësime/mësues/e. Krahas kësaj, Raporti theksoi nevojën për riorientimin e fokusit të arsimit drejt platformave edukativo-arsimore të mundësuar nga teknologjia informative, si praktikë e rregullt shkollore në shekullin e 21-të. Në përgjithësi, pandemia shihet si mundësi e mirë për të reflektuar dhe për të vepruar me qasje të reja drejt ndryshimeve që do të adresonin probleme afatgjata të sistemit arsimor në Kosovë.

Një ndër **rekomandimet** kryesore të Raportit ishte plotësimi i kuadrit ligjor për adresimin e sfidave të dala nga pandemia në tërësi, konkretisht rishikimin dhe përmirësimin e mekanizmave të këshillimit dhe mbështetjes në shkolla. Gjithashtu u nënvizua nevoja për miratimin sa më të shpejtë të strategjisë për digjitalizimin e arsimit dhe zhvillimin e kompetencave digjitale. Më tej u rekomandua adresimi i duhur i humbjeve mësimore, koordinim më i mirë mes niveleve të ndryshme të arsimit qendror dhe lokal, mbështetja e vazhdueshme e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve, optimizimi i autonomisë së shkollave dhe financimit të tyre, përmirësimi i sistemit për menaxhimin e informatave etj.

Diskutimi virtual, ku u prezantuan të gjeturat e Raportit, theksoi rolin jetik të mësimitdhënësve si bartësit e barrës më të rëndë të punës gjatë pandemisë. Shumë prej tyre kanë nisur menjëherë mësimin online, pavarësisht nga mungesa e përvojës ose mungesa e njohurive të nevojshme për përdorimin e platformave të duhura. Udhëzuesit e MASHTI-t kanë qenë shumë të dobishëm në këtë drejtim, meqenëse përmbajnë pjesë lidhur me përdorimin e TIK-ut në mësimitdhënie. Disa mësimitdhënës kanë hartuar doracakë me udhëzime rreth përdorimit të platformës Zoom, të cilët i kanë shpërndarë tek kolegët/et dhe uebfaqja e shkollës. Ndërkohë që digjitalizimi është nevojë e padiskutueshme për fuqizimin e mësimit, duhet rrjetëzuar më i madh mes shkollave për të ndarë praktikat më të mira. Po ashtu, u sugjerua që institucionet arsimore t'i përfshijnë më shumë mësimitdhënësit në proceset e hartimit të strategjive dhe dokumenteve bazë të arsimit; për këtë qëllim duhet komunikim më i mirë me qëllim të koordinimit më të mirë të punës.

Pjesëmarrësit u dakorduan se duhet bërë më shumë për të adresuar jo vetëm impaktin akademik të pandemisë, por edhe impaktin mbi shëndetin mendor dhe fizik të fëmijëve në arsimin parauniversitar. Për këtë qëllim duhen ngritur mekanizma adekuate me bazë ligjore dhe me bazë në shkollë.

Sa i përket bashkëpunimit me prindër, u sugjerua që Raporti do të mund të plotësohej me një seksion të veçantë kushtuar përfshirjes së prindërve në mësimin nga shtëpia, për shkak të rëndësisë themelore të binomit shkollë-familje.

Pikë qenësore e diskutimeve ishte rëndësia e mbështetjes së vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë në bashkëpunim me institucionet vendore dhe shoqërinë civile, ku u theksua rëndësia thelbësore e arsimit në zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Në përgjithësi, sfida kryesore e arsimit parauniversitar në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19 u konstatua të ishte ballafaqimi me pasigurinë në tërësi, dhe vendosja e shëndetit në rend të parë, sidomos shëndeti i fëmijëve.

Në tërësi, Raporti u konsiderua se ofronte një shikim të vlefshëm mbi situatën e arsimit parauniversitar në Kosovë në kushtet e pandemisë Covid-19. Diskutimi publik ku u prezantuan të gjeturat e këtij Raporti ishte po ashtu mjaft aktiv dhe produktiv.

Ndryshimi i mendësive dhe qasjeve të palëve të përfshira në arsimin parauniversitar tregon se tashmë është shtruar rruga drejt shfrytëzimit të metodave më praktike dhe më produktive për realizimin e mësimin. Fakti që mësimdhënësit dhe nxënësit iu përshtatën shumë shpejt situatës së re është sinjal shpresëdhënës, ku e njëjta gjë vlen edhe për mënyrat kreative në trajtimin e vështirësive të paparashikuara, pavarësisht nga zbrazëtitë institucionale dhe mungesa e ekspertizës.

Ky diskutim publik është pikënisje shumë e mirë për identifikimin e problematikës shumëdimensionale të arsimit parauniversitar në Kosovë në kushtet e pandemisë Covid-19. Sado që një pjesë e sfidave të përmendura janë probleme ekzistuese qysh para pandemisë, kjo e fundit është mundësi shumë e mirë për të gjetur mënyra të reja dhe optimale për t'i adresuar dhe trajtuar ato. Raporti do të shërbejë si bazë orientuese për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit parauniversitar dhe si bosht referimi për të parë ecurinë e proceseve në të ardhmen.

Ky editorial është hartuar nga Bora Shpuza Kasapolli në kuadër të programit “Cilësia, Llogaridhënia dhe Gjithëpërfshirja në Arsim 2021” zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbajtja e këtij editoriali në asnjë mënyrë nuk mund të merret si reflektim i qëndrimeve të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.